



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 26 tetor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T P Ë R S H Ë N D E T Ë S I, P U N Ë
D H E M I R Ë Q E N I E S O C I A L E

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca dhe Aurora Bakalli.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahimit- UNDP, Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.10.2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 19.10. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 19 tetor 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Fikrim Damka- Grupi i punës ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe sot do të vendosim për secilin amendament veç e veç dhe këto amendamente do t'i përcjellim në komisionet e përhershme, sipas procedurës së paraparë me rregullore.

Flora Brovina- Si kryesuese e grupit të punës, i informoi anëtarët e Komisionit për punën e bërë nga grupi punues. Kryesuesja Flora Brovina njoftoj anëtarët e Komisionit se ka pasur takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore dhe të FMN –së , dhe se kërkesa e tyre është se nuk mund të përfshihen në këtë Ligj veteranët, pa u bërë verifikimi i numrit të veteranëve dhe pa u bërë përlogaritja e koston së Projektligjit.

Në emër të grupit të punës, Komisionit ia paraqiti këto amendamente:

Amendament 1

Titulli i Projektligjit riformulohet „**Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre**”

Amendament 2

Në tërë tekstin e Projektligjit në vend të „ Lufta e UÇK –së “ të jetë „Lufta Çlirimtare e Kosovës” .

Amendament 3

Në nenin 3, para paragrafit 1.1 të shtohet paragraf i ri „

1.1. „Lufta Çlirimtare e Kosovës” është lufta e armatosur e popullit për liri, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në periudhën nga 30.12.1991 deri më 20.6.1999;

Amendament 4

Në nenin 3, paragrafi 1 .6 riformulohet „

“1.6. **Dëshmor i Luftës Çlirimtare të Kosovës**” është pjesëmarrësi i Luftës Çlirimtare të Kosovës që:

1.6.1. Ka rënë në luftë kundër okupatorit nga 30 dhjetori 1991 deri më 20 qershor 1999;

1.6.2. Është plagosur nga forcat e armikut brenda periudhës së cekur në nenin 1.6.1 dhe ka vdekur brenda 3 viteve nga dita e plagosjes;

1.6.3. Si shtetas i huaj është vrarë në Luftën Çlirimtare të Kosovës;

Amendament 5

Në nenin 3, pas nënparagrafit 1.6 shtohet nënparagraf i ri „ **Dëshmor i Lirisë** ” është veprimtari që ka kontribuar për çështjen kombëtare individualisht ose i organizuar në grup, i cili është vrarë nga armiku nga viti 1945 deri më 30 dhjetor 1991;

Amendament 6

Në nenin 3, paragrafi 1.7 riformulohet :

1.7. “Invalid i Luftës Çlirimtare të Kosovës” është pjesëmarrësi i Luftës Çlirimtare të Kosovës, organizmi i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në Luftë për Çlirimin të Kosovës, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut, prej 30.12.1991 deri më datën 20.06.1999

Amendament 7

Në nenin 3, paragrafi 1.9 riformulohet :

1.9. “Veteran i Luftës Çlirimtar të Kosovës,” është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili në mënyrë të organizuar, ka punuar në përgatitjen, organizimin dhe ka marrë pjesë në Luftës Çlirimtare të Kosovës , të udhëhequr nga UÇK, kundër pushtuesit brenda periudhës 30.12.1991 deri më 20.06.1999;

Amendament 8

Në nenin 3, paragrafi 1.10 , fshihet .

Amendament 9

Në nenin 3, nënparagrafi 1.16 , fjala „prindërit” kalon para fjalës „ njerka”.

Amendament 10

Në nenin 3 , pas paragrafit 1.16 , shtohet paragraf i ri si vijon :

“Familje e Dëshmorit të Luftës Çlirimtare” është ajo familje e cila i ka dhënë Kosovës një apo më shumë Dëshmorë në Luftën Çlirimtare.

Amendament 11

Në nenin 3, paragrafi 1.18, riformulohet

1.17 „ **ZKLÇ**” është Zyra për Kategoritë e dala nga Lufta Çlirimtare e Kosovës

Amendament 12

Në nenin 4 , në fund të paragrafit , para „ UÇK-së”
hyn fjalia „ në Luftën Çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga “.

Amendament 13

Në nenin 5 , nënparagrafi 1.1.5 , riformulohet dhe ndahet në dy nënparagrafë :
1.1.5 Pensionin familjar, familja e ngushtë e realizon për dëshmorët e Luftës Çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga UÇK, të rënë nga 30 dhjetori 1991 deri me 20 qershor 1999 ;

1.1.6 Pensionin familjar, familja e ngushtë e realizon për të zhdukurit nga 1 janarit 1998 deri me 31 dhjetorit 1999;

Amendament 14

Në nenin 5, pas paragrafit 1.2 , hyn një paragrafi i ri si vijon :

„ **Pension personal i veteranit** “ është pension të cilin e gëzon veterani i Luftës Çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga UÇK .

Amendament 15

Në nenin 6, paragrafin 1.3 fjala „ invalidëve të UÇK-së” zëvendësohet me „ invalidët e Luftës Çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga UÇK “ dhe në fund të paragrafit shtohet fjala „ dhe veteranët “

Amendament 16

Në nenin 6, paragrafin 1.7, në fund të paragrafit fshihet fjalia „ sëmundja e shkaktuar nga “

Amendament 17

Në nenin 6, paragrafi 3, në fund të paragrafit , fshihet fjalia „ në rast të vështirësisë financiare” dhe zëvendësohet me „në rast të gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale”.

Amendament 18

Në nenin 6, paragrafi 6, dhe 6.1 pas fjalës „invalidëve “ shtohet fjalia „ veteranëve “ .

Amendament 19

Në nenin 6, në paragrafët 7 dhe 8 në fund të paragrafëve , pas fjalës „ tyre “ shtohet fjalia „ dhe veteranët, në kushte të barabarta “.

Amendament 20

Në nenin 8, paragrafi 1.7, dhe në nenin 9 , paragrafi 1.14 në fund të paragrafëve fshihet fjalia „ vështirësive financiare’’ dhe zëvendësohet me „ gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale’’.

Amendament 21

Në nenin 8, paragrafi 2, riformulohet „, Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve, të Luftës Çlirimtare të Kosovës ‘’.

Amendament 22

Në nenin 9 paragrafi 1.16 , të fshihet .

Amendament 23

Në nenin 10 , paragrafin 1.1 , riformulohet „, Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor;

Amendament 24

Në nenin 11, paragrafi 5, pas fjalës „, vdekur ‘’ shtohet fjala „, brenda ‘’ .

Amendament 25

Neni 12 , fshihet dhe riformulohet si vijon „,

Statusi dhe të drejtat e veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga UÇK

1. Veteranët e Luftës së Çlirimtare të Kosovës, të udhëhequr nga UÇK , sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Ligj, i realizojnë këto të drejta dhe beneficione:

1.1. Të drejtën në pension personal të
Luftës, kur e arrin moshën pesëdhjetë (50) vjeçare;

1.2 Baza e pensionit të veteranit, caktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Kosovës

1.3. Veteranët e punësuar-vetëpunësuar, me rastin e pensionimit të tyre në moshën gjashtëdhjetepesë (65) vjeçare të drejtën në pension personal të luftës do ta realizojnë sipas nënparagrafit 1.2 të këtij neni;

1.4. Veteranët e Luftës së Çlirimtare të Kosovës, të cilët në cilësinë e ish pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, realizojnë pensionin e TMK-së, sipas dispozitave të

Ligjit nr. 03/l-100, për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, nuk mund ta realizojnë të drejtën në pension personal të luftës sipas dispozitave të nenit 12 të këtij ligji.

1.5. Stazh të dyfishtë, për kohën e kaluar në luftë;

1.6. Përkujdesje shëndetësore primare, sekondare dhe terciare pa kompensim në institucionet publike shëndetësore;

1.7. Përparësi në punësim me kushte barabarta;

1.8. Përparësi regjistrimi dhe pranimi në institucionet arsimore publike në kushte të barabarta;

1.9. Përparësi në bursë për shkollim të mesëm dhe universitar në kushte të barabarta;

1.10. Lirimin nga tatimi në pronë për objektet e banimit, për veteranët e UÇK-së;

1.11. Lirimin nga taksat gjyqësore dhe Administrative;

1.12. Përparësi vendosjeje në konvikte në kushte të barabarta;

1.13. Aftësimin dhe riaftësimin profesional;

1.14. Lirim nga pagesa në trafikun urban dhe ndër urban në sektorin publik ;

1.15. Lirimin 50% nga dogana, për një veturë personale çdo shtatë (7) vite .

1.16. Kompensimin e shpenzimeve të varrimit së bashku me nderimet ushtarake.

2. Të drejtat dhe beneficionet nga ky nen veteranet do ti gëzojnë pas verifikimit të statusit të veteranëve nga Komisioni Qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve.

3. Të drejtat në pension personal të luftës, për veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës do të fillojnë të realizohen prej 1.01.2015. Deri atëherë duhet të kryhen procedurat e

verifikimit të statusit të veteranëve, nga Komisioni Qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve .

Amendament 26

Në nenin 13, paragrafi 1.4, në fund të paragrafit fshihet fjalia „ vështirësive financiare’’ dhe zëvendësohet me „ gjendje të rëndë ekonomike, dhe i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale’’.

Amendament 27

Në nenin 14 , paragrafi 2.1. fshihet „ mbi 80% ‘’ dhe zëvendësohet me „ 81%-100%’’

Amendament 28

Në nenin 14, paragrafi 5, fshihet „ 80% ‘ dhe zëvendësohet me„ 40%’’.

Amendament 29

Në nenin 15, paragrafi 5, pas nënparagrafit 7.9 shtohet një nënparagraf i ri : „Ish Ministrisë së Mbrojtjes ‘’.

Amendament 30

Në nenin 16 , paragrafi 2, pas fjalës „ Departamentit’’shtohet fjalia „ të Ministrisë’’pas fjalës „ dëshmorëve ‘’ shtohet fjala„ Veteranëve ‘’ dhe në fund të paragrafit fshihet fjala „ Ministrisë’’dhe zëvendësohet me „ Luftës ‘’.

Amendament 31

Titulli i nenit 17,riformulohet „ **Zyra për Çështjet e kategorive të dala nga Lufta Çlirimtare e Kosovës** ‘’ dhe të bëhet harmonizimi në tërë nenin .

Amendament 32

Në nenin 17 , paragrafin 2.2, pas fjalës „ kombit’’ shtohet fjalia „ të dëshmorëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës ‘’

Amendament 33

Ne nenin 18 , te shtohet paragrafi i ri si vijon :

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit për të drejtën në pension, për veteranët është 1 (një) vit .

Amendament 34

Në nenin 20 ,paragrafi 1.1.1 , në fund të paragrafit pas fjalës „ kombit “ shtohet fjalia „ dëshmorëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës ”.

Amendament 35

Në nenin 20 , paragrafi 1.4.3 fjalia „ të anëtarëve të familjeve të ngushta “fshihet dhe zëvendësohet me „ anëtarëve të ngushtë të familjeve “.

Amendament 36

Titulli i nenit 22 , riformulohet „ Trajtimi i kërkesave në shqyrtim “.

Amendament 37

Në nenin 23, paragrafin 1, në fund të paragrafit , pas fjalës „ Ligji “ të shtohet fjala „pas verifikimit nga komisioni qeveritar i paraparë në nenin 15, të këtij Ligji.

Amendament 38

Neni 25 , të fshihet.

Amendament 39

Në tërë projektligjit të bëhet harmonizimi i teksteve në tri gjuhët.

Anëtarët e Komisionit njëzëri votuan amendamentet një nga një , për amendamentin 25, deputetja Salihe Mustafa propozoj qe ky amendament të mos votohet dhe te shtyhet miratimi i tij deri pas takimit me FMN dhe me Bankën Botërore.

Me 6 vota kundër dhe 2 për, nuk kaloi propozimi i deputetes Salihe Mustafa, që të shtyhet votimi i amendamentit 25.

Komisioni njëzëri votoi të gjitha amendamentet e propozuara nga grupi i punës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka